



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 22, datë 06.12.2021

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Dhjetor, që zhvillohet me mjete të komunikimit elektronik (aplikacioni SKYPE).

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 06.12.2021

Mbajtja e mbledhjes : Online aplikacioni SKYPE

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Rradhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Znj.Emiriana Sako, që kryen funksionet e Kryetarit Bashkisë, dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Të nderuar Këshilltarë! E nderuar Kryetare !

Uroj që të jeni mirë të gjithë familjarisht.

E deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë rradhe të Këshillit Bashkiak Durrës me mjete të komunikimit elektronik. Kjo mbledhje është kërkuar nga Kryetarja në Detyrë. Siç jeni vënë në dijeni materialet Ju janë vënë në dispozicion nga Sekretarja e Këshillit në rrugë elektronike dhe ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj prezencën online.

Dorina Milja: Përshëndetje të gjithëve! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent...ok....etj....deri te Morena Boja..... ka votuar me email.

Një sekond Eni, Alfred Mullaraj votoi me email, kështu që u bënë 9 email. Më kontrollon Afrim Bakaj.

Eneida Marku (asistenca teknike) : Po prezent është.

Silvana Kavaja : Jam prezent

Eneida Marku (asistenca teknike): Afrim Bakaj është prezent .

Dorina Milja: Edhe Silva prezent ?

Eneida Marku (asistenca teknike): Po

Dorina Milja: Indrit Cërloj ?

Eneida Marku (asistenca teknike): Jo

Dorina Milja: Qoshi ?

Eneida Marku (asistenca teknike): Jo

Dorina Milja: Atëherë Kryetar ke 30 këshilltarë online dhe 9 vota me email.

(Hyn me vonesë Flutura Kasa dhe Indrit Cërloj kanë shkruar prezent në chat dhe votoi me email dhe Klodian Kërtusha, kështu që janë 32 këshilltarë online dhe 10 email. Gjithsej 42 vota në mbledhje)

Ani Dyrmishi: Dorina faleminderit. Atëherë meqë kuorumi është i pranishëm vazhdojmë me shqyrtimin e rendit të ditës dhe miratimin e tij. Siç jemi njoftuar të gjithë me email, sot kemi 3 pika për të shqyrtuar në rendin e ditës ku njëra është shtesë nga këto 3.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT 4 TË VKB-SË NR.123, DATË 24.12.2020 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2021, SI DHE PROJEKTBUXHETIN AFATMESËM TË BASHKISË DURRËS PËR VITET 2021-2023”
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT DHE DETAJIMIT TË FONDIT PREJ 388’182’835 LEKË PA TVSH NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.715, DATË 24.11.2021 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT E TË RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLAT) NË BASHKITË TIRANË, DURRËS DHE MIRDITË”
Pika shtesë 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR PUBLIK TË TERRITORIT PREJ 27.500 M ² , NË ZBATIM, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 561, DATË 15.7.2020 “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË FSHATIN LALËZ, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA DURRËS”

Në lidhje me rendin e ditës kemi ndonjë koment nga ana këshilltarëve?....

Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

.....(ndërkohë qetësi, po votohet në chat)...

Kundra?Apstenim?..... Ju lutem votoni të gjithë kush nuk ka votuar ende.

Eni ka përfunduar procesi i votimit, mund të ma konfirmosh?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Ende jo Ani. Deri tani të gjithë kolegët kanë votuar pro rendit të ditës.

Ani Dyrmishi : Atëherë kush nuk ka votuar ende, Ju lutem të votojë.

Eneida Marku (asistenca teknike) : Përfundoi procesi.

Ani Dyrmishi : Atëherë me të gjitha votat pro miratohet dhe rendi i ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 1 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

Alneida Roshi : Faleminderit ! Përshëndetje !

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike për pikën 1 të rendit të ditës propozon në mënyrë unanime për ta kaluar. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit. Komisioni Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave, znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj: Faleminderit z. Kryetar. Mirëdita të gjithëve!

Komisioni ynë vendosi me të gjitha votat pro miratimin e pikës parë të rendit të ditës. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Etleva Velçani.

Etleva Velçani : Përshëndetje ! Edhe Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, pasi shqyrtoi të gjithë relacionin është dakort me vota unanime për kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit!

Komente përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës kemi nga ana e këshilltarëve ?.....

Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim . Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

.....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra? Apstenim?..... Votoni të gjithë ju lutem.

Eni ma konfirmon?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Po Ani, kolegët kanë votuar pro pikës 1 të rendit të ditës.

Ani Dyrmishi : Atëherë me shumicë të votave miratohet dhe pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 2**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

Alneida Roshi : Faleminderit Kryetar!

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike edhe për pikën 2, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit. Komisioni Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave, znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj: Edhe Komisioni ynë vendosi me të gjitha votat, pro miratimit të kësaj pike. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit. Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Elio Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar!

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë dhe propozon miratimin e saj. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit dhe Ju!

Komente përsa i përket pikës 2 të rendit të ditës kemi nga ana e këshilltarëve ?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim . Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

.....(*ndërkohë qetësi... votohet në chat*).

Kundra?Apstenim?..... Ju lutem votoni.

Ju lutem kush nuk ka votuar ende, të votojë...

Eni kur të mbaroi procesi i votimit, të lutem ma konfirmo.

Eneida Marku (asistenca teknike) : Atëherë kolegët kanë votuar pro pikës 2 të rendit të ditës.

Ani Dyrmishi : *Atëherë me shumicë votash miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit të **pikës 3**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

Alneida Roshi : Faleminderit !

Edhe për pikën 3, Komisioni Rregullores propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor znj.Denisa Luarasi.

Denisa Luarasi : Përshëndetje Kryetar! Përshëndetje koleg !

Edhe Komisioni Pronave Publike, propozon të kaloj për votim pika 3 e rendit të ditës, bazuar në aktekspertizat përfundimtare. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Etleva Velçani.

Etleva Velçani : Po. Edhe Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, votoi pro kalimit në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit!

Komente përsa i përket pikës 3 të rendit të ditës kemi nga ana e këshilltarëve ?.....

Atëherë nuk ka, kalojmë në votim . Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

.....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra? Apstenim?..... Ju lutem kush nuk ka votuar ende të votojë....

Eni të lutem ma konfirmon, është mbyll procesi?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Kolegët ende nuk kanë përfunduar së votuari dhe deri më tani kemi 3 apstenime për pikën 3.

Ani Dyrmishi : Atëherë ma konfirmo kur të mbyllet.

Eneida Marku (asistenca teknike) : Kolegët kanë përfunduar votimin. Votimi ka përfunduar dhe kemi 3 apstenime për pikën 3.

Ani Dyrmishi : Atëherë me 4 vota apstenim dhe shumica tjetër pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

Eneida Marku (asistenca teknike) : 3 vota apstenim.

Ani Dyrmishi : Jo, jo 4 se është dhe 1 me email.

Eneida Marku (asistenca teknike) : ok

Ani Dyrmishi : Atëherë 4 vota apstenim dhe tjerat pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- **Fjalën nga këshilltarët** e ka kërkuar dhe z. Valentino Mustaka.

Valentino Mustaka : Përshëndetje !

Unë desha nuk e di me bo një vërejtje, një diçka kështu për këshilltarët, për ankesat që kanë qytetarët, për propozimet që bëhen. Unë shoh një indiferentizëm shumë të madh. Edhe unë me thënë të drejtën jam shumë i dezilizjolum nga mos reflektimi i të gjithë atyre mendimeve, propozimeve ose problemeve që kanë qytetarët. Po shikoj diçka kështu vetëm thuj pro, thuj pro, thuj pro dhe mbaron puna me kaq. Unë nuk jam dakort.

Pika e parë “Ne” si pallat kemi bërë një letër në vitin 4.2.2020, me numër protokolli 1717 dhe asnjë përgjigje nuk është dhënë, asnjë përgjigje. Të paktën të jepet përgjigja negative. Ore zotëri nuk jemi dakort që të merret njeri me pallatin Tuaj, kur ai pallat është bërë nuk di, nuk di çka të them një shprehje popullore, ta shikosh nga jashtë është një turp i madh, një turp i madh. Nuk

merrem pastaj me gjërat personale që as nuk çahet koka fare hiç nëse ti ke ndonjë ankesë. Nuk e di, unë jam shumë i delizizjolum për këtë punë dhe nuk e di ça, a të iki fare nga ky Këshill Bashkiak, nuk e di ça do bëj. Do marr një vendim në fund edhe...

Ani Dyrmishi : Faleminderit Valentino. Kryetarja ?...

Emiriana Sako : Po faleminderit për fjalën.

Sa i takon ankesës që, protokollin që përmendët do ta verifikojmë keni marrë s'keni marrë përgjigje. Ne nuk marrim përsipër që të kthejmë përgjigje që nuk merremi me pallatet se jemi një qytet, i cili sapo ka bërë 2 vite nga dëmi që ka pasur nga tërmeti kështu që patjetër të gjithë ankesat merren parasysh. Çështja është se projektet në vetvete duan kohën vetë. "Ne" kemi përfunduar dhe projektet, që kishim marrë përsipër për të realizuar dhe tashmë janë në fazë që kërkojnë financim nga Ministria e Shtetit për Rindërtimin dhe kjo nuk është kompetencë e bashkisë së Durrësit. Pra, për aq kohë sa nuk ka ardh investimi "Ne" nuk kemi çfarë bëjmë për pallatin, prap duke e ditë që dhe nevojat që ka dhe qyteti i Durrësit.

Ky fond që miratuam sot është një fond, i cili prek objektet me dëme nga ds1 tek ds3-shi dhe me këtë miratim që bëmë sot do të fillojmë procedurën për realizimin e ndërhyrjeve në 180 objekte në qytetin e Durrësit me këto kategori të ulëta dëmi. Kështu që shpresojmë të jetë dhe objekti juaj në këtë listë. Nëse jeni në një listë tjetër pastaj duhet të presim projektin e detajuar, të cilin bashkia.....

Valentino Mustaka : Zonja Kryetare !

Emiriana Sako : Të lutem ta mbaroj ..

Valentino Mustaka : Po, po mbaroje..

Emiriana Sako : Bashkia i ka mbaruar si projekt-preventivat, ka marrë dhe oponencat nga ana Institutit dhe është dorëzuar kërkesa për financim. Nga ana tjetër problemet personale që Ju keni adresuar në komunikimin, që kemi patur së bashku do merret në konsiderat, pra fjala është për një garazh që ke në pallatin tënd , garazhi do mbyllet kur të vi puna që do mbyllet teknikisht për të gjithë kuotat e katit përdhe, kështu që mendoj se nuk është vëndi për ta diskutuar këtu se jemi për një qëllim tjetër.

Valentino Mustaka : Dakort, qëllimi tjetër dakort. Unë e kam të qartë që Ju nuk e zgjidhni dot atë punën e garazhdit tim, me vu 30 tulla atje, nuk e zgjidhni dot Ju, sepse ka 6 muaj ky muhabet.

Emiriana Sako : Objekti është në kantier akoma, kur të mbaroj objekti do të futet dhe garazhi.

Valentino Mustaka : Mua garazhin nuk ma prishi tërmeti zonja Kryetare, ma prishi firma bashkë me Ju të bashkisë.

Emiriana Sako : Në rregull.

Valentino Mustaka : Dhe keni të drejtë Ju të ma riparoni. Sa për pallatin aty ke pika 2-të unë nuk doja të isha kundra aty po atje thuhet dhe sistemimet. Nuk mund të futet dot ke sistemimet kjo?

Emiriana Sako : Është një kategori dëmi që nuk e vendos Bashkia. Është e përcaktuar me inxhinjer, pra nga Instituti dhe inxhinjerët, që kanë bërë konstatimet në vënd. Nuk i heqim dot “Ne” pallatet si ta mendojmë, hiqe këtë të kaloj nga këtu apo anasjelltas ka projekte të detajuara për të gjitha ndërhyrjet që bëhen me fondet publike të dhënë nga qeveria shqiptare.

Valentino Mustaka : Projekti bëhet si ta duash vet zonja Kryetare, megjithatë faleminderit shumë për përgjigjen.

Ani Dyrmishi: Faleminderit dhe ju Valentino.

Faleminderit të gjithë Këshilltarëve. Faleminderit Kryetare.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Do të njoftoheni për mbledhjen e rradhës në rrugë elektronike nga Sekretarja e Këshillit.

Emiriana Sako : Faleminderit. Punë të mbarë.

Ky procesvebal mbyllet me nr.rendor 7(shtatë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkcionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

ELIO JANI

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI